



Shqata për Energji të Ripërtëritshme e Kosovës  
Oda Ekonomike e Kosovës, Rruga Nëna Terezë Nr. 20  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
[sherk.ks@yahoo.com](mailto:sherk.ks@yahoo.com) • [info@sherk.net](mailto:info@sherk.net)  
[www.sherk.net](http://www.sherk.net)

### Ankesa per “Tarifa nxiteze per caqe shtese te BRE-ve”

Te nderuar,

Si pale te interesit, ne kemi analizuar me kujdes Raportin Konsultativ per Mekanizmin e mbeshtetjes per caqet e BRE-ve te punuar nga ZRRE dhe kemi vendosur qe te shprehim kundershtimin tone lidhur me tarifen nxiteze te propozuar nga ana juaj.

Si SHERK shprehim interesimin e antarve tone per investime ne fushen e energjise se ripertrishme, perkatesisht ne energji solar, megjithate tarifa nxiteze prej 90.4 euro per MW/h energji te prodhuar, konsiderojme qe perveq qe nuk eshte e favorshme per ne si investitor, as nuk e arsyeton nje investim te tille e as nuk eshte rantabile.

Pas shume konsultimeve me eksperte te fushes, kemi arritur ne konkluzionin qe shpenzimet kapitale (Capex) qe sipas Raportit Konsultativ jane nga 750 mijë deri ne 900 mijë euro per MW fuqi te instaluar nuk pasqyrojne shumen reale te investimeve ne Kosove. Eshte evident fakti qe ne tregjet nderkombetare verehet nje renie e lehte e çmimit per panelet solare, megjithate nuk perben nje renie substanciale e cila do te ndikonte ne drejtperdrejte ne renie edhe te shpenzimeve kapitale totale, duke qene se shpenzimet tjera mbesin po te njejtat ose me raste edhe jane rritur. Ketu vlen te permenden kostot e kyqjes, kostot e blerjes se tokes, kostot e puneve ndertimore (rruga dhe objektet) te cilat konsiderojme qe rrisin ne mase te konsiderueshme shpenzimet kapitale. Njeherit, Shpenzimet Operative (Opex) kane mbesin te pandryshuara.

Sipas analizes tone Shpenzimet Kapitale per 1 MW fuqit te instaluar variojne nga 1.05 deri ne 1.1 Milione euro dhe si rrjedhoje mendojme qe nje tarife nxiteze nen 100 Euro nuk eshte ekonomike dhe si rrjedhoje as nuk arsyeton nje investim te tille.

Prandaj, ne lusim ZRRE qe ta rishqyroje edhe njehere Tarifen Nxiteze te propozuar ne Raportin Konsultativ te Maj 2019 dhe te vije ne nje tarife e cila do te ishte atraktive dhe ekonomike per investitoret dhe do te nxiste ne plotkuptimin e fjalet investime ne fushen e BRE.

Me respekt,

“SHERK”

Kryetari

Bekim Shyti

+383 49 990 111